REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Lënda: Mbi Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2019

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 88/2018 "Për Buxhetin e vitit 2019", udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grup i Menaxhimit Strategjik, relacioni dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Në kërkesat buxhetore për vitin 2019, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, si produkt kryesor në realizimin e objektivit ka përcaktuar, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 50 çështje. Për periudhën janar - dhjetor 2019, Kolegji ka marrë në shqyrtim 63 çështje me një realizim prej 126 %.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit në zbatim të ligjit nr. 88/2018 "Për Buxhetin e vitit 2019", për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për vitin 2019, janë përcaktuar në vlerën ***139 (njëqind e tridhjetë e nëntë) milionë lekë***. Me vendim nr. 730 datë 13.12.2019, të Këshillit të Ministrave, është akorduar një shtesë në buxhetin vjetor në vlerën ***2 (dy) milionë lekë.***

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2019, është ***128.6 milionë lekë*** ose ***91.2 %***. Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Programi	**Llogaria ekonomike**	**Emërtimi**	**Plani vjetor (000/lekë)**	**Realizimi vjetor (000/lekë)**	**% realizimit**
03340	6000000	Paga	108.200	107.250	**99 %**
03340	6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetësore	9.600	9.350	**97 %**
03340	6020000	Mallra e shërbime	18.500	8.259	**45 %**
03340	2310000	Investime kapitale	4.700	3.721	**79%**
		TOTALI	**141.000**	**128.580**	**91 %**

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2019 në paga është ***96 milionë lekë***. Nisur nga fakti që vlera e mësipërme ishte e pamjaftueshme për mbulimin e nevojave për fond page të institucionit, me shkresat nr. 15775/1 prot., datë 17.07.2019 dhe nr. 20618/2 prot., datë 21.11.2019, Ministria e Financave ka miratuar kërkesat tona për rialokimin në total të vlerës ***12.2 milionë lekë,*** nga llogaria ekonomike 602 (shpenzime për mallra e shërbime), në llogarinë ekonomike 600 (shpenzime për paga).
Buxheti përfundimtar i miratuar në paga, për periudhën janar - dhjetor 2019, është ***108.2 milionë lekë*** dhe përbën rreth 77 % të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2019.
Realizimi paraqitet në vlerën ***107.3 milionë lekë*** ose ***99.1 %*** të planit vjetor dhe përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 43 (dyzet e tre) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 101, datë 04.10.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe pagat për 4 (katër) punonjësit me kontratë të përkohshmë pune. Gjithashtu në këtë masë të realizimit të buxhetit, ka ndikuar edhe pagesa me 2 paga mujore, si vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2019 në sigurime shoqërore është ***8.3 milionë lekë***. Me shkresën nr. 15775/1 prot., datë 17.07.2019, Ministria e Financave ka miratuar kërkesën tonë për rialokimin e vlerës ***1.3 milionë lekë,*** nga llogaria ekonomike 602 (shpenzime për mallra e shërbime), në llogarinë 601 (shpenzime për sigurime shoqërore).
Buxheti përfundimtar i miratuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar- dhjetor 2019, është ***9.6 milionë lekë*** dhe përbën rreth 9 % të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2019.
Realizimi paraqitet në vlerën ***9.3 milionë lekë*** ose ***97.4 %*** të planit vjetor. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihet një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2019, në shpenzime operative është ***30 milionë lekë***, duke tejkaluar kërkesat buxhetore të Kolegjit për vitin 2019, të paraqitura në dokumentin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2019-2021. Pas rialokimeve të kryera, buxheti i rishikuar në shpenzime operative është ***18,5 milionë lekë*** dhe përbën 13.1% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2019.
Realizimi për periudhën janar- dhjetor 2019, i këtij grupi është rreth ***8.3 milionë lekë*** ose ***44.6 %*** të planit vjetor.

Në mënyrë shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	**Realizimi viti 2019 (në lekë)**
Materiale pastrimi e higjeno-sanitare	**402.720**
Kancelari, letër	**628.280**
Materiale për funksionimin e zyrave (toner për printer/fotokopje)	**1.362.120**
Shpenzime për energji elektrike	**1.142.400**

Shpenzime për furnizimin me ujë	**80.810**
Shërbime telefoni mobile	**445.017**
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	**145.033**
Shërbime printimi, publikimi (njoftime për shpallje te vendeve vakante)	**834.565**
Shërbime transporti (parkim për automjetin e institucionit + lavash + mirëmbajtje)	**304.300**
Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit	**755.232**
Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur (shpenzime telefonie)	**1.155.000**
Shpenzime për tatim & taksa të paguara nga institucioni (taksat vendore)	**232.303**
Shpenzime te tjera	**501.129**
TOTALI	**8.258.909**

Gjatë periudhës janar - dhjetor, janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale të punës së përditshme si kancelari, letër, toner për pajisjet e printimit, materiale pastrimi, mirëmbatje etj, me vlerë totale 2.894.249 lekë.

Është prokuruar shërbimi i telefonisë celulare për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesve të administratës, si dhe shërbime për automjetin e institucionit (pjesë këmbimi, vend parkim, siguracion etj), me vlerë totale 749.317 lekë.

Janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë dhe shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar) me vlerë totale 1.638.243 lekë.

Janë shlyer detyrime lidhur Njoftim Vlerësimi Tatimor për gjoba dhe interesa për deklarime dhe detyrime të paguara me vonesë gjatë periudhës qershor-shtator 2017.Gjithashtu janë paguar taksat vendore të Bashkisë Tiranë për vitet 2017-2019, si dhe kamatë vonesa dhe interesa të llogaritura mbi to, për mos pagesë në afat të detyrimeve. Vlera totale e paguar për sa sipër është 232.303 lekë.

Në zërin "Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur" me vlerë 1.155.000 lekë, është pasqyruar vlera totale e kompensuar gjyqtarëve për shpenzimet e telefonisë celulare, sipas kuotës 15.000 lekë/muaj, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 2, datë 14.01.2019.

Në zërin "Shërbime printimi, publikimi", me vlerë 834.565 lekë, janë pasqyruar pagesat e kryera për shpallje në shtypin e shkruar të njoftimeve për vendet vakante (gjithsej 16 shpallje për 14 poste pune), sipas vendimmarrjes së Komitetit Ad Hoc .

Në zërin "Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit", në vlerë 755.232, janë pasqyruar shpenzimet e kryera për:

- Pjesëmarrjen e delegacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në takimin e 11-të të Nen komitetit Bashkimi Evropian - Shqipëri " Drejtësia, liria, siguria", në Bruksel në datat 23-25 prill 2019. Shpenzimet e kryera për këtë aktivitet janë 199 mijë lekë për bileta ajrore dhe 185 mijë lekë për akomodim në hotel dhe dieta.
- Pjesëmarrjen e delegacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në takimin e 10-të të Komitetit të Stabilizim Asociimit 2019, në Bruksel në datat 13-15 nëntor 2019. Shpenzimet e kryera për këtë aktivitet janë 121 mijë lekë për bileta ajrore dhe 248 mijë lekë për akomodim në hotel dhe dieta.

Gjatë vitit 2019, nuk është përdorur fondi i parashikuar për shpenzime për pjesëmarrje ne konferenca, pritje përcjellje, shpenzime për prodhim dokumentacioni (dosje gjyqësore etj) etj, pasi nuk u paraqit nevojë për kryerjen e këtyre shpenzimeve gjatë vitit.

Një pjesë e fondit të papërdorur lidhet me diferencat e krijuara nga procedurat e prokurimit gjatë vitit në zërat: kancelari, letër, tonera, mbrojtje kundër zjarrit etj. si dhe mospërdorimin e plotë të fondeve për energji elektrike, sherbime telefonike, shërbimi postar, udhëtim e dieta jashtë vendit.

IV. Investime kapitale (431)

Buxheti i miratuar në investime, për periudhën janar- dhjetor 2019, është ***4.7 milionë lekë***, për projektet si vijon:

Kodi i projektit	**Emërtimi i projektit**	**Plani Viti 2019 (000/lekë)**	**Realizimi Viti 2019 (000/lekë)**
M630002	Blerje pajisje dhe mobilie zyre	730	449
M630013	Blerje pajisje elektronike	870	755
M630021	Software formatimi vendimesh gjyqësore	100	0
M630022	Sistem video salle gjyqi	3.000	2.517
TOTALI		**4.700**	**3.721**

Gjatë vitit 2019 janë kryer procedurat e prokurimit për plotësimin e nevojave për punonjësit me mobilje dhe pajisje si tavolina pune, arshiva metalike, aparate telefonik etj. Gjithashtu janë prokuruar pajisje elektronike për stafin e ri, si dhe paisja Firewall që është pajisja bazë për sigurinë në rrjet e cila bllokon ndërhyrjet apo sulmet e ndryshme që mund të vijnë në rrugë elektronike nga jashtë institucionit.
Ka përfunduar procedura e prokurimit dhe instalimit për sistemin video në sallën e gjyqit me operatorin ekonomik fitues “Pc Store” për vlerën totale 2.9 milionë lekë.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.